

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor ¹	Data e kërkesës ²	Objekti i kërkesës ³	Data e përgjigjes ⁴	Përgjigje ⁵	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁶	Tarifa ⁷
1	11.01.2021	Kërkesë për informacion	1.02.2021	Referuar kërkesës suaj për informacion, ju bëjmë me dije se për periudhën mars-dhjetor 2020, numri shfaqjeve të realizuara online ose në skenë është si më poshtë vijon: 1. Teatri Kombëtar, ka realizuar 40 shfaqje online 2. Teatri I Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor, ka realizuar 47	Me email	Nuk ka

¹ Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve

² Data e regjistrimit të kërkesës

³ Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁴ Data e kthimit të përgjigjes

⁵ Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁶ Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar

⁷ Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.

				<p>shfaqje ne skenë dhe 8 online</p> <p>3. Teatri Kombëtar Eksperimental, ka realizuar 57 shfaqje skenike.</p> <p>4. Teatri I Metropolit, është institucion në varësi të Bashkisë Tiranë, MK nuk disponon të dhëna.</p> <p><u>MBESHTETJA PER KOMUNITETIN E ARTISTEVE PER VITIN 2020</u></p> <p>Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019 – 2025, & Plan Veprimi në zbatim të dokumentit Strategjik 2019 – 2025, i cili kontribuon për qëllimin e politikës, lidhur me programet buxhetore të MK në fushën e Artit,</p>	
--	--	--	--	--	--

				<p>kulturës e Trashëgimisë kulturore.</p> <p>MK në planet e asaj afat- shkurtër dhe afatgjatë, për të patur dhe krijuar një mjedis të qëndrueshëm ligjor e institucional për zhvillimin e artit dhe kulturës, gjithmonë i është referuar, kerkesave, standarteve dhe modeleve të Bashkimit Europian. Në vijim këtu përfshihen edhe fillimi i punës për;</p> <ul style="list-style-type: none">- hartimi dhe miratimi i Ligjit për Pensionet e Profesioneve të vështira;- Reformimi i Ligjit të Artit dhe Kulturës;- Reformimi i Ligjit për Kinematografinë etj. <p>Ne vijim edhe përforcimi i mekanizmave rregullatorë lidhur me respektimit të së drejtës</p>	
--	--	--	--	--	--

			<p>së autorit, çka do të ndikojë edhe në nxitjen e krijimtarisë.</p> <p>Link attached https://kultura.gov.al/ep-content/uploads/2020/01/finale-Strategjia-Komb%C3%ABtare-p%C3%ABr-Kultur%C3%ABn-2019-2025.pdf</p> <p>Në zbatim të Urdhrit të MSHMS Nr.132/08.03.2020 “Për mbylljen e aktiviteteve publike dhe jopublike dhe anulimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura”, të Urdhrit të Ministrisë së Kulturës Nr.141/11.03.2020 si edhe në vijim të masave të marra nga Qeveria (Vendim Nr.243, datë 24.3.2020 “Për shpalljen e Gjendjes së fatkeqësisë</p>	
--	--	--	---	--

			<p>natyrore”), është pezulluar aktiviteti i të gjitha institucioneve kulturore qendrore si edhe të gjitha aktiviteteve kulturore të skenës së pavarur, si: teatër, opera, balet, ekspozita, bienale, festivale si edhe veprimtari kulturore në hapësira të hapura, aktivitetet kulturore për fëmijë janë mbyllur të gjithë muzetë, parqet dhe kalatë.</p> <p>Megjithatë në kuadër të mbështetjes së sektorit, MK ka mbështetur dhe inkurajuar mbështjen për çdo organizatë kulturore jofitimprurëse, individët, artistët, profesionistët në sektorin e kulturës dhe të industrisë creative, për të paraqitur projekt-propozime të cilat ishin brenda normave të kushtëzuara, duke pershtatur aktivitetet.</p>		
--	--	--	---	--	--

				<p>Në kuadër të Thirrjes për projekte për vitin 2020 “E ardhmja është në origjinë” janë mbështur:</p> <ul style="list-style-type: none">- 27 aplikime kryesisht të formatura si aktivitete dhe te pershatura për shkak të situatës COVID,- 67 projekte të brendshme (Individ dhe OJF). <p>Në mbështetje të artit, dhe në vijim të zbatimit të Startegjisë, MK synon gjithëpërfshirjen dhe mbështetjen e krijimtarisë së artistëve shqiptarë, duke përfshirë në keto aktivitete kulturore sa më shumë të rinj, në kuadrin edhe të Paktit për Universitetin duke nxitur aktivitetin e skenës së pavarur</p>		
--	--	--	--	--	--	--

				<p>kulturore si edhe duke stimuluar industrinë creative, mbështetjen e krijuesve dhe organizatave të pavarura kulturore, me qëllim zhvillimin dhe promovimin e sektorëve kulturorë dhe synim pavarësimin e tyre në tregun e sotshëm.</p> <p>Formalizimi i sektorit është një prioritet dhe MK inkurajon çdo artist për tu mbështetur dhe bazuar në parimin kontributiv apo edhe me përfshirjen e tyre në Fonde investimi të cilat janë praktika dhe metoda të njohura për sektor të vecantë si këtu në Shqipëri por edhe botë</p>		
2	15.01.2021	Lidhur me pallatin nr.14, zona kadastrale nr.8514, pasuria nr. 1/362, Bulevardi “Dyrrah”, Durrës (i vlerësuar për shembje sipas akt ekspertizës së	29.01.2021	Të interesuarit I janë vendosur në dispozicion materialet e kërkuara.	Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail	Nuk ka

		thelluar të Institutit të Ndërtimit), për të cilin aktualisht ka nisur procesi i rindërtimit, kërkoj dokumentet publike dhe informacion lidhur me: 1. A ka sjellë Instituti i Arkeologjisë një kërkesë për leje lidhur me gërmimin arkeologjik paraprak me qëllim studimor në sheshin e ndërtimit përpara nisjes së tij? 2. Nëse po, a e ka miratuar Ministria e Kulturës? 3. Na vendosni në dispozicion dokumentet që posedoni lidhur me rastin.				
3	25.01.2021	1. Ftesa dhe axhenda e takimeve, dërguar nga pala pritëse dhe shkresa përcjellëse e saj ku përfshihen edhe kostot e mbuluara prej palës pritëse (udhëtim, fjetje, akomodim, ushqim në vlerë monetare etj.) 2. Programin e punës në lidhje me këtë takim	10.05.2021	Të interesuarit I janë vendosur në dispozicion materialet e kërkuara.	Informacioni është tërhequr dorazi, për shkak të volumit.	Nuk ka

		<p>ku të argumentohet rëndësia e pjesëmarrjes, numri i pjesëmarrësve dhe kostot e mbuluara nga pala shqiptare.</p> <p>3. Urdhërin e shërbimit që miraton kryerjen e shërbimit.</p> <p>4. Detajimi i kostove që mbulohen nga buxheti i shtetit që shoqërojnë urdhrin.</p> <p>5. Urdhrin e prokurimit/shpalljen e njoftimit për biletat.</p> <p>6. Faturën e biletës së udhëtimit nga agjencia turistike, shoqëruar me rezervimin e gjeneruar nga sistemi i shoqërive ajrore.</p> <p>7. Formularin e paradhënies (në vlerë monetare) për dieta, akomodim, transport të firmosur nga udhëtuesi dhe sektori i financës</p> <p>8. Faturën e akomodimit në hotel të gjeneruar nga hoteli dhe firmosur nga udhëtuesi.</p> <p>9. Faturat që</p>				
--	--	---	--	--	--	--

		<p>mbështesin shpenzimet për transport.</p> <p>10. Boarding pass-et e nisjes dhe mbërritjes.</p> <p>11. Formularin e "Urdhrit Shërbimit për Jashtë Vendit" të plotësuar dhe firmosur pas kthimit në Tiranë.</p> <p>12. Raport/relacion shërbimi që plotësohet nga pjesëmarrësit pas kthimit nga shërbimi jashtë vendit.</p>				
4	28.1.2021	<p>Kërkohet kopje e kontratës me nr. 3168, datë 06.07.2005 për dhënien me qira të ambjenteve të Qendrës Ndërkombëtare të Kulturës (Piramida), subjektit TopMedia/Digitalb.</p>	24.02.2021	Kontrata i është vendosur në dispozicion	Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail	Nuk ka
5	22.02.2021	<p>1- Sa kanë qenë fondet për 5 vitet e fundit(2016-2021) që janë dhënë për mirëmbajtjen e vilëve/banesa monument kulture në qytetin e Tiranës të cilat janë shpallur</p>				

		<p>monument kulture në vitin 2015?</p> <p>2- Sa prej këtyre vilave/banesa monument kulture të shpallura në vitin 2015, janë rikonstruktuar gjatë 5 viteve të fundit (2016-2021)? Sa prej këtyre janë në plan për tu rikonstruktuar për 5 vitet e ardhshme?</p> <p>Çfarë ndodh me këto vila/banesa monument kulture nëse ato degradojnë totalisht? E kujt është përgjegjësia e mirëmbajtjes?</p>				
6	9.04.2021	<p>“Grupin e eksperteve që ka aprovuar procesin e muzealizimit të Mësonjëtorja Korçë”</p>	15.04.2021	Kërkuesit I është vendosur në dispozicion informacioni I kërkuar	Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail	Nuk ka
7	15.04.2021	<p>Kërkesë për informacion: Për sa i përket periudhës kohore 25 mars-25 prill:</p> <p>-A ka marrë ministri i institucionit leje vjetore?</p>	16.04.2021	Kërkuesit I është vendosur në dispozicion informacioni I kërkuar	Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail	Nuk ka

		<p>-A ka pasur urdhër shërbimi për të lëvizur nëpër qytete të ndryshme?</p> <p>-Nëse ka pasur urdhër shërbimi, cili ka qenë argumenti i këtij urdhëri?</p>				
8	06.05.2021	<p>1. Listën e çeljeve buxhetore në nivel projekti investimi dhe njësie zbatuese të detajuar sipas viteve (2020,2021,2022). Të gjitha çeljet buxhetore në SIFQ të kryera në nivel projekti në zbatim të VKM-ve për rindërtimin në fund të vitit 2020.</p> <p>2. Listën e regjistrimeve të PO urdhër-prokurimeve (me datë regjistrimi në SIFQ dhe datë urdhëri) me vlera përkatëse në nivel projekti investimi dhe njësie zbatuese.</p> <p>3. Listën e kontratave/angazhimeve e buxhetore të regjistruara në SIFQ me vlerën e plotë në</p>	19.05.2021	<p>Gjatë vitit buxhetor 2020, në zbatim të <u>VKM-së nr. 213, datë 11.03.2020 “Për caktimin e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore si njësi zbatuese, dhe për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e restaurimit/rindërtimit të pasurive kulturore”, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, institucion në varësi të Ministrisë së Kulturës ka përfituar Fonde të Rindërtimit në vlerën prej 236,627,000 lekë. Në zbatim të</u></p>	Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail	Nuk ka

		nivel projekti investimi, subjekti fitues i kontraktuar dhe njësia zbatuese (detajimin e vlerës së plotë sipas viteve të zbatimit [2020,2021,2022]).		pikës nr.3 të VKM-së nr.213, datë 11.03.2020 nga ku citohet se <u>“Në fund të vitit buxhetor, fondet e pashpenzuara, pas përfundimit të procedurave në zbatim të këtij vendimi, kthehen në buxhetin e fondit për rindërtimin dhe trashëgohen në vitin pasardhës”</u> , <u>Instituti Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore</u> , gjatë vitit buxhetor 2021, janë shtuar fondet e pashpenzuara nga viti 2020 me vlerë 45,784,422 lekë.		
9	21.05.2021	Kërkesë për informacion, për "Ura e Zogut", mbi lumin Mat, lutem nga ana juaj dhenien e informacionit per sa kerkohet: - Ura është shpallur	01.06.2021	Kërkuesit i është vendosur në dispozicion informacioni i kërkuar	Përfunduar. Kthim përgjigje me postë	Nuk ka

		<p>monument kulture në vitin 1999. A ka bërë ndonjë investim Ministria e Kulturës përgjatë 21 viteve për mirëmbajtjen e kësaj vepre?</p> <p>- Ura ka filluar të shkatërrohet, njëra këmbë po fundoset. A ka një projekt Ministria e Kulturës për rehabilitimin e kësaj vepre? Nëse po, sa është fondi dhe çfarë investimesh parashikohen në këtë monument?</p> <p>- Prefektura e Lezhës, por edhe Bashkia e Lezhës, Ju kanë dërguar kërkesa për ndërhyrje. Përse nuk është ndërhyrë?</p>				
10	25.05.2021	1- Cilat kanë qënë llojet e dëmtimeve të objekteve historike të	21.06.2021	Kthyer përgjigje nga IKTK	Përfunduar. Kthim përgjigje me postë	Nuk ka

		<p>dëmtuara nga termeti i 26 nëntorit në Durrës?</p> <p>2- Cilat nga këto objekte që janë dëmtuar (Specifikoni zonën)</p> <p>3- Kur do të nisë restaurimi i këtyre objekteve historike të dëmtuara?</p> <p>4- Sa buxhet është planifikuar për këtë projekt?</p>				
11	25.05.2021	<p>1- Cilat janë ato monumente të kulturës (Kala) të cilat do të ndriçohen për të nxjerrë në pah vlerat e tyre? (Specifikojeni me emra Kalatë)</p> <p>2- Sa buxhet është hartuar në lidhje me këtë projekt?</p>	21.06.2021	<p>Nga informacioni i përcjellë informohemi se përmes buxhetit të shtetit është bërë i mundur hartimi i projekteve për ndriçimin e 15 kalave si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Me Vendimin e KKTKM nr. 540 datë 29.12.2020 është miratuar projekti 	Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail	Nuk ka

				<p>“Hartimi i projektit elektrik për ndriçimin e jashtëm të 15 kalave:</p> <ul style="list-style-type: none">• Kalaja Bashtovës;• Kalaja Borshit;• Kalaja Durrësit• Kalaja Elbasanit• Kalaja Himarës• Kalaja Kaninës• Kalaja në kepin e Rodonit• Kalaja Lezhës• Kalaja Libohovës• Kalaja Peqinit• Kalaja e Petreles• Kalaja Porto Palermos• Kalaja	
--	--	--	--	--	--

				<p>Prezës</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kalaja Shurdhahut • Kalaja Tiranës <p>Njëkohësisht lidhur me zbatimin e tyre Ministria e Kulturës do t vijojë me planifikimin dhe ngritje ne fondeve në vijim.</p>		
12	18.06.2021	Referuar ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, do te doja te informohesha ne lidhje me procedurat ligjore si dhe pajisjen me lejet perkatese nga Ministria e Kultures dhe Qendra Kombëtare e Veprimtarive Folklorike. Festivali folklorik ka per qellim prezantimin e traditave kulturore folklorike te vendeve te Ballkanit dhe eshte zgjedhur pikerisht vendi yne, per te mirepritur nje	21.06.2021	Per organizimin e nje Festivali Folklorik Ballkanik duhen patur parasysh : 1. Ministria e Kulturës nuk jep licenca apo leje per organizimin aktivitetesh kombetare apo nderkombetare. 2. Nese aktiviteti do te organizohet ne ndonje monument kulture (kala, park Arkeologjik, etj.) paraqitet nje kerkese per aktivitetin , vendin, oren dhe datat qe do te zhvillohet per të marre	Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail	Nuk ka

		<p>organizim te tille. Ne menyre qe nje festival i permasave te tilla, te jete sa me dinjitoz do te donim nje bashkepunim te ngushte dhe te frytshem me institucionin tuaj. Per te nisur organzimin do te donim te informoheshim fillimisht ne lidhje me procedurat ligjore te aplikimeve perkatese, lejet dhe dokumentacionin qe eshte i nevojshem ne kete rast, per organizimin e festivalit.</p>		<p>leje nga Ministria e Kultures, bazuar ligjeve ne fuqi. 3. Nese do te kerkohet mbeshtetje financiare nga Ministria e Kultures per aktivitetin, ju ne jme me dije se Ministria e Kultures cdo muaj dhjetor shpall thirrjen per projekte ne fushen e artit, kultures dhe trashegimise kulturore se bashku me dhe kriteret perkatese per pjesemarrje, ku mund te aplikohet per ndihme financiare per aktivitetin qe do te zhvilloni. 4. Per sa i perket vendit ku do te organizohet aktiviteti, organizatorët duhet te bashkepunojne ngushte me organet e pushtetit vendor të qytetit apo njesise administrative ku do te organizohet festivali (per ndihme financiare, akomodimin e</p>	
--	--	---	--	---	--

				artisteve, ushqimin, vendin e shfaqjeve, foni, ndricim, transport, etj).		
13	14.06.2021	<p>Kërkesën për informacion në lidhje me Kulla Gjon Marka Gjonit (Shkodër) - Kategoria I. Monument Kulture.</p> <p>Në përputhje me Ligjin për të Drejtën e Informimit, unë kërkoj që të pajisem me numrin e regjistrimit të kësaj kerkese si dhe me informacionin e plotë të kërkuar brenda kohës së caktuar të këtij ligji.</p>	23.06.2021	Kthim përgjigje nga IKTK	Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail	Nuk ka